



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit

Seancë dëgjimore me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”.

(Komisioni përgjegjës)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Florjon Mima, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Bujar Muça, Tatiana Nurçe, Lorenc Luka, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Robert Bitri dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ejana Xhixha - Kryeinspektore në ISHMT

Valbona Jaupllari - Drejtoreshë Teknike në ISHMT

Jualian Llupo – Drejtor i Mbikëqyrjes së Produkteve në ISHMT

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Në vijim të axhendës së kësaj jave, sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”.

Ju bëj me dije se kemi shtyrë datën e shqyrtimit në seancë parlamentare, pikërisht, për shkak të një numri sugjerimesh, komentesh dhe vërejtjesh për të debatuar në lidhje me ndryshimet e paraqitura. Ka një numër të konsiderueshëm ndryshimesh të paraqitura, të cilat nga sot do të fillojmë t’i diskutojmë dhe t’i debatojmë.

Ju rikujtoj, deputetë se nëse ka kërkesa për grupe, shoqata apo individë, të cilët duan të kontribuojnë në përmirësimin e draftit, janë më shumë se sa të mirëpritura ka 2-3 sugjerime nga ana juaj. Kështu që, sot ne do ta diskutojmë me thellësi. Relator kemi zotin Vullnet Sinaj. Të ftuar kemi zonjën Ejana Xhixha, kryeinspektore, zonjën Valbona Jaupllari, drejtoreshë Teknike dhe zotin Jualian Llupo, drejtor i Mbikëqyrjes së Produkteve në ISHMT-ë, të cilëve ju uroj mirëseardhjen në komision!

Zoti Sinaj, sugjeroj që t’ia japim fjalën kryeinspektores, që të na bëjë një përshkrim, pasi ka qenë një drejtori e shumëpritur për t’u krijuar, kemi të paktën 5- 6 vjet që bëjmë debate në komision dhe në seanca parlamentare. Personalisht më ka ardhur turp në takimin e fundit që kam pasur me përfaqësuesit e Bashkimit European, në mos gaboj në vitin 2014, ku kishin kërkuar prej kohësh fillimin e punës, por jo vetëm fillimin e punës, por të fillonim nga gjërat e thjeshta, të paktën një *website*, ku të ishin të listuara të gjitha produktet tregtare që ekzistojnë në Shqipëri. Nuk folëm për gjëra filozofike dhe për gjëra të mëdha, por folëm për disa përgjigje, të disa pyetjeve, të cilat, për turpin tonë, nuk dinin t’i përgjigjeshin në vitin 2014. Oguri i mirë është se më në fund kemi një inspektorat, kemi një kryeinspektore.

Zoti Sinaj, në cilësinë e relatorit dhe të deputetit, do të sugjeroja që ta japim fjalën kryeinspektorësh, që të na bëjë një përshkrim të shkurtër të krijimit, si po funksionon dhe më pas kalojmë te diskutimi për ligjin konkret, nëse do të ketë. Dakord me rendin e ditës?

(Diskutim pa mikrofon)

A keni ndonjë gjë në lidhje me rendin e ditës? Nuk keni.

Atëherë, zonja Xhixha fjala për ju.

Ejana Xhixha - Përshëndetje!

Faleminderit për ftesën dhe mundësinë për t'u dëgjuar në këtë komision të nderuar, i cili është një nga partnerët institucionalë shumë më të rëndësishëm për të gjitha tregjet, që janë nën monitorimin dhe fushë përgjegjësisë së këtij Inspektorati!

Ashtu sikurse ju nënvizuat në parashtresën tuaj është një institucion, i cili i ka munguar hierarkisë administrative institucionale deri në vitin 2016. Pas sugjerimeve dhe rekomandimeve të vazhdueshme të Bashkimit Europian, por edhe të nevojës së brendshme të tregjeve, dhe të konsumatorëve, në janar të vitit 2016 nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 36, është krijuar juridikisht Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut me tri fusha kryesore veprimtarie: Drejtoria e Inspektimit të Sigurisë së Përgjithshme të Produktit, Drejtoria e Inspektimit të Standardit në Turizëm dhe Drejtoria e Inspektimit të Pronësisë Intelektuale, ku përfshihet e drejta e autorit dhe pronësia industriale, pra markat dhe patentat.

Kemi një strukturë të miratuar prej 90 personash, jemi ent juridik me personalitet të veçantë, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, me seli ende pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, pra ende nuk kemi selinë tonë. Kemi pasur probleme esenciale për t'u ngritur.

Personalisht kam filluar në janar të vitit 2017 në pozicionin që kam, dhe më pas kemi vijuar me procesin e rekrutimit. Siç kuptohet, fushat e përgjegjësisë absolutisht janë shumë të gjera, prekin pothuajse 90% të tregjeve. Ndërkohë struktura për një institucion të ri ishte parashikuar, të ngrihej sipas ligjit "Për rekrutimin në shërbimin civil", i cili merr kohën e tij, ka vështirësitë e tij dhe ne vetëm në fund të qershorit 2017 kemi arritur të bëjmë një rekrutim prej rreth 30% të numrit total të stafit. Duke qenë se kjo periudhë përkonte me periudhën e fillimit të sezonit turistik, vëmendjen kryesore në vitin 2017, pra në korrik e në vijim, ia kushtuam, ia dedikuam pikërisht inspektimit të standardeve në turizëm, kryesisht për stacionet e plazhit, ku janë inspektuar në një kohë rekord nga inspektorët të saporekrutuar, të cilët ishin në periudhë prove, nuk kishin eksperiencë në inspektim, por që për fat ishin disa funksione të transferuara nga Ministria e Kulturës, rasti i inspektimit të së drejtës së autorit dhe inspektimi metrologjik nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, të cilat u transferuan si funksione, por dhe si stafe pranë Inspektoratit tonë. Për shkak se ligji i shërbimit civil, por edhe ligji specifik i inspektimit kërkon që inspektorët në periudhë prove, nuk mund të nënshkruajnë akte ligjore të tipit procesverbal, vendim përfundimtar gjobe, nëse nuk janë të konfirmuar, kjo solli një sforcim shumë të madh, duke i dhënë rëndësinë e duhur, pikërisht në atë periudhë kohore inspektimit të stacioneve të plazhit, kryesisht për pajisjen e tyre me kontrata apo jo. Ne vjet kemi inspektuar rreth 700 stacione plazhi në të gjithë territorin e

republikës, ku është konstatuar një mangësi e theksuar në qarqe të caktuara të lidhjes së kontratave midis pushtetit vendor dhe operatorëve ekonomikë që kryejnë këtë funksion. Pasi janë informuar operatorët dhe në bashkëpunim të ngushtë me bashkitë gjatë këtij procesi, si efekt i inspektimit ne kemi arritur që vetëm në 50 masa administrative nga 700 inspektime të kryera, për shkak të detyrimit të lënë në inspektim të lidhim rreth 300 kontrata dhe janë hartuar në buxhetin e bashkive respektive në total rreth 20 milionë lekë të rinj.

Të gjitha masat administrative, me përjashtime shumë të vogla, 10% e tyre, kanë mbetur në fuqi dhe në shqyrtimin gjyqësor dhe mund të them se kjo ka qenë një histori suksesi për një sfidë të një institucioni të ri, në një spektër të ri, në operator që nuk kishin informacion as për institucionin, por as për detyrimin që kishin për të qenë të formalizuar në këtë lloj raporti me pushtetin vendor.

Bashkëpunimi me pushtetin vendor, për hir të së vërtetës, ka lënë shumë për të dëshiruar dhe ne jemi përpjekur në vijimësi t'i alartojmë, sepse Këshilli i Ministrave e ka ezauruar detyrimin e tij, flasim për sigurinë në plazhe, ka miratuar një kontratë tip, e cila, në momentin që bashkia e lidh me operatorin ekonomik, presumohet që operatori i ka përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara në kontratë. Kjo për sa i përket inspektimit të standardeve në turizëm për vitin 2017.

Më tej kemi vijuar me procesin e rekrutimit të siguria e përgjithshme e produktit. Siguria e përgjithshme e produktit është një drejtori, e cila është e organizuar në 4 sektorë, kryesisht fushëverpimtaria e këtyre sektorëve është: sektori i inspektimit të produkteve mekanike, të produkteve elektrike- elektronike, lëkurë që u heq këpucë detergjenteve dhe e inspektimit metrologjik, funksion i cili më parë është mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, por për shkak të një konflikti të mundshëm interesi është transferuar jashtë tyre. Siç kuptohet nga spektri i veprimtarisë, kërkohet një fushë ekspertize inxhinierike, e cila, për fat të keq, sidomos të produktet mekanike, është shumë e ndjeshme vakanca që ka tregu dhe pamundësia për të furnizuar me ekspertizë dhe në ende sot të ky produkt nuk kemi asnjë rekrutim, pavarësisht se kemi bërë tri shpallje dhe të tria janë mbyllur pa kandidatë dhe si rrjedhim pa fitues. Kështu që kjo ka qenë një nga vështirësitë. Vështirësia tjetër është se këto janë funksione që kryhen për herë të parë. Ligji kryesor “Për tregtinë në Republikën e Shqipërisë”, dhe daton në vitin 2011 dhe kemi një vakum midis vitit 2011 dhe daljes në treg të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut në vitin 2018, të cilën, sigurisht, në parimin kushtetues të detyrimit për të njohur legjislacionin secili operator në publikimin në Fletore Zyrtare e ka detyrimin të njihet dhe të ndërtojë biznesin e tij, por ka munguar pikërisht hallka ndërlidhëse midis ligjit të miratuar detyrimeve ndaj operatorëve dhe

operatorëve në njohjen e tyre dhe në orientimin apo sanksionimin, në rast moskorrigjimi, të shkeljeve të konstatuara, të sanksionuara nga një institucion administrativ, në rastin konkret të inspektimit. Kryesisht, ne kemi filluar me ndërtimin e një databaze, sepse është e pamundur që më pas të vazhdojmë me metodologjinë e hartimit të riskut, të prioritizimit të operatorëve dhe të listimit të tyre mbi bazë risku dhe shumë problematika të tjera, të cilat lidhen me mospasjen e databazes.

Gjithashtu, fokus kryesor ka qenë ndërveprimi me shoqata e biznesit dhe me operatorët, atje ku kemi vajtur i kemi trajtuar proceset e inspektimit si proces informimi, këshillimi dhe lënie detyrash. Atje ku ligji specifik nuk paraqitet ndryshe, pra ne operojmë me ligjin e tregtisë, me ligjin e inspektimit, që është ligji kuadër, rregullator i procedurave dhe ligji specifik në rastin konkret i metrologjisë apo i të drejtës së autorit, apo i pronësisë industriale, të cilat janë ligje që prevalojnë mbi ligjin kuadër të inspektimit. Domethënë, kemi raste kur edhe ligji na lejon që të japim këshillim, ashtu sikurse ka raste flagrante, në rastin e ligjit specifik, që detyrimisht kërkon përgjim të menjëhershëm të shkeljes për të mos dëmtuar interesin konsumator.

Një tjetër aspekt është ndërveprimi me institucione të tjera, nuk është e thjeshtë, por jo e pamundur që në historinë e institucioneve një institucion i ri të krijojë hapësirën e tij ndërvepruese, bashkëpunuese, por edhe të ndihmës reciproke të nevojshme në institucionet e reja. Jemi në fazën që kemi një draftmarrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, pikërisht për të mundësuar një kontroll paraprak për të gjitha ato grupe produktesh që kanë një rregull teknik, një standard teknik të kërkuar, në mënyrë që në momentin që ato importohen dogana të jetë filtri i parë për të vlerësuar konformitetin e tyre në pikëpamje dokumentare. Ne jemi në fazën që, edhe me ndërmjetësimin e një projekti të GIZ-it dhe të një eksperti të kësaj fushe të ofruar nga ata, jemi në këtë tratativë. Gjithashtu, jemi në tratativa dhe kemi dërguar për mendim disa marrëveshje të tjera me AKEP-in, me AMA-n, me Ministrinë e Kulturës dhe me krimin ekonomik, pra janë procese ligjore institucionale, që duan kohën dhe vëmendjen e tyre, por pasi të njihemi me procesin.

Pjesa kryesore e vëmendjes sonë, pavarësisht sfidave dhe ngarkesave administrative për të kryer këto procese, ka qenë informimi i operatorëve ekonomik, i cili, për fat të keq, rezulton se lë shumë për të dëshiruar dhe do të jetë vijim konsistentë i institucionit tonë, sepse bizneset në grup industrish janë në mosnjohje thuajse të plotë të detyrimeve që kanë nga ligjet specifike. Kështu që ne kemi hartuar materiale informimi, të cilat i kemi publikuar edhe në faqen tonë të internetit, të cilën e kemi mundësuar me mbështetjen e projektit të GIZ-it dhe kemi informacion të përgjithshëm, por dhe të detajuar mbi grup produktesh se çfarë

rregullash teknike kanë, çfarë legjislacioni i mbulon dhe cilat janë detyrimet konkrete të operatorëve ndaj konsumatorit dhe strukturës ku ata operojnë.

Një problematikë e shtuar në këtë drejtori është situata me ashensorët e Republikës së Shqipërisë. Inspektorati i Mbikëqyrje së Tregut ka detyrimin që të ndërtojë regjistrin kombëtar të ashensorëve. Ky është një detyrim që buron nga ligji i miratuar në vitin 2011, kur nuk kishim një strukturë përgjegjëse, siç është sot Inspektorati, por mënyra se si ka funksionuar dhe ka rrjedhur gjëja nga viti 2011 dhe deri në vitin 2018 e ka bërë një situatë, që do shumë ndërveprim për ta futur në proces, sepse sot, për fat mirë, tempizmin me instanca të tjera publike është perfekt. Bashkia e Tiranës është drejt konkludimit të procesit të emërimit të administratorëve të banesave, të cilët, sipas ligjit, janë personat përgjegjës në rastin kur person përgjegjës nuk është më ndërtuesi, i cili e ka afatin 5 vjet, pasi godina është marrë në dorëzim nga komuniteti i banorëve. Pikërisht për këtë arsye ne kemi marrë kontakte me bashkinë dhe kemi organizuar trajnime për administratorët e certifikuar nga Bashkia e Tiranës dhe që kanë një kontratë pune me një godinë, për të njohur përgjegjësitë dhe detyrimet që kanë, sepse procesi është disa palësh, nis nga administratori, janë trupat inspektuese palë tretë, janë trupat *notified bodies*, që bëjnë markimin CE dhe Inspektorati është hallka e fund që mbikëqyr detyrimet e zbatuara nga të gjitha instancat e mësipërme.

Lajmi i mirë është se vjet në korrik të vitit 2017 mungonin dhe instrumentet e tjerë të tregut, siç ishin trupat e autorizuar palë e tretë për inspektimin periodik dhe për markimin CE. Në vitin 2017 kanë dalë dy operatorë, që në pikëpamja infrastrukturore e lehtësojnë procesin. Tani qarku është i plotësuar në pikëpamjen e strukturës së komponentëve të nevojshëm. Kemi ndërmarrë disa fushata informimi dhe këshillimi, duke i ndarë me grupe industrish, pikërisht aty ka risk të shtuar dhe frekuencë më të lartë përdorimi. Siç ju thashë, kemi filluar me administratorët e pallateve të Bashkisë së Tiranës, i kemi drejtuar një shkresë të gjitha bashkive të Republikës së Shqipërisë për të na thënë numrin e godinave, meqenëse bashkia është entiteti që jep lejen e ndërtimit dhe lejen e shfrytëzimit dhe se sa është numri i godinave me ashensor në territorin e tyre. Jemi në fazën kur një pjesë e bashkive kanë raportuar, një pjesë shpresoj të jenë në proces. Ndërkohë, kemi kontaktuar me të gjitha njësitë që ofrojnë shërbime, si qendrat tregtare, hotelëritë, qendrat e kujdesit shëndetësor, të cilat janë më të ekspozuara ndaj këtij risku, në mënyrë që të fillojë e të bëhet regjistri kombëtar i ashensorëve.

Eduard Shalsi – A keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar në lidhje me aktivitetin, apo do të vijojmë me pyetjet?

Ejana Xhixha – Ne kemi shumë për të folur, sepse kemi shumë sfida. Për këtë arsye edhe në fillim të fjalës sime ju falënderova për ftesën, sepse është partneriteti i parë me një institucion të rëndësishëm vendimmarrës që na jep mundësinë të flasim për ato që kemi bërë dhe ato që pritet të bëjmë së bashku.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Xhixha!

Ne sot po hapim siparin e një komunikimi që nuk do të mbetet këtu, por do ta vazhdojmë. Ky është një institucion, të cilin, qëkur jam në parlament, e kam hasur në çdo raport të BE-së dhe për çdolloj kërkesë ne nuk kemi pasur përgjigje. Fatmirësisht e kemi, por jemi të bindur se duhet të fuqizuar dhe duhet të fillojë të veprojë.

Në çfarë raporti është ky inspektorat me Inspektorin e Përgjithshëm apo me inspektoratet e veçanta pranë çdo ministrie? Shpeshherë në vëmendjen tonë ka ardhur një shqetësim për mbivendosje kompetencash, pra mbaron një inspektorat dhe shkon një tjetër, të cilët herë kërkojnë të njëjtën gjë dhe herë kërkojnë gjëra të ndryshme. Ka një mungesë koordinimi midis tyre. Pra, në çfarë raporti është me inspektoratet? Dimë që prej vitesh ka filluar një reformë për mënyrën e inspektimit në Shqipëri. Mbajini shënim pyetjet, që në fund fare t'u përgjigjeni të gjithave.

Fjalën e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Dua thjesht një saktësim të shkurtër. Vërtet ju sot mund të jeni bërë një drejtori shumë e madhe, por...

Eduard Shalsi – Nuk është drejtori, por inspektorat.

Besnik Baraj – Atëherë, drejtori të mbrojtjes së konsumatorit dhe të inspektimit të tregut ka pasur që në vitin 2002, ku mbaj mend se ka qenë drejtor Ben Hoti etj., në Ministrinë e Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thashë, ngaqë u tha se ka munguar si hierarki. Ndoshta ka qenë në përmasa më të vogla.

Eduard Shalsi – Pra, ka pasur një drejtori.

Zoti Hoxhalli.

Hekuran Hoxhalli – Ju thatë se keni konstatuar rreth 700 raste me problematika të ndryshme dhe keni marrë 50 masa administrative. Po me 650 rastet e tjera çfarë ka ndodhur?

E dyta, a keni ndonjë statistikë se si kanë qenë të shpërndara këto kontrolle në kohë, por edhe në bazë territori? Në cilat rajone kanë qenë problematikat më të mëdha?

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Beqaj, mund ta merrni fjalën.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Meqenëse struktura funksionon praktikisht prej 2 vjet e gjysmë (nëse mbrojtja ideale e konsumatorit do të ishte 100, apo nëse do të ishte 0) a mund të thoni se sa është përmirësuar mbrojtja e konsumatorit gjatë këtyre viteve në Shqipëri?

Ky projektligj që ka ardhur, prek më shumë se gjysmën e neneve të ligjit. Meqenëse ju thatë se vjet u fokusuat tek turizmi dhe meqenëse momenti ku jemi përkon me pikëne turizmit, dua të bëj një konstatim. Për mua është pak e rëndësishme nëse ai operatori që punon ditën në diell e ka apo nuk e ka kontratën me bashki, e rëndësishme është që vizitori, turisti të marrë atje një shërbim siç duhet. Si kanë qenë raportet midis standardit që duhet të ketë një strukturë e tillë dhe faktit se sa është distanca midis shezllonëve, brezi i parë publik, tualetet, mbeturinat, dushet, rojet bregdetare? Përmendët ashensorët, por ashensorë ka edhe nëpër hotele, nuk ka vetëm nëpër pallate. Edhe sot që flasim nëpër ashensorët tanë nuk ka një që të thotë se në filan datë ka ardhur një kontroll i caktuar. Edhe sistemet antizjarr hotelet i kanë të instaluar, se ndryshe nuk e marrin dot lejen e shfrytëzimit, por pastaj atë inspektimin çdo muaj nëse i punon apo nuk i punon presoni nuk e bën asnjë.

Kam edhe një kuriozitet, meqenëse thatë që në faqen e internetit keni shumë klikime: a mund të më thoni se sa klikime në ditë ka mesatarisht faqja juaj? Ju vërtet atje tregoni se çfarë duhet të dinë subjektet, të cilat deri më sot rezultojnë pak të informuara, dhe kjo është një gjë e mirë, pra, në qoftë se faqja është aty, të klikohet, por duhet të gjenden edhe forma të tjera se si të komunikojmë më këto subjekte, të cilat, sipas konstatimit tuaj, janë pak të informuara për detyrimet që kanë.

Sigurisht, në momentin kur thatë se keni detyrë të mbulonit rreth 90% të aktivitetit të përditshëm të konsumatorëve, ku konstatoini se ka ende fusha që kanë mungesë kompetencash ligjore, administrative apo personeli, sepse ka ende boshllëqe dhe duhet të rritet shërbimi ndaj qytetarëve? Ka disa gjëra që duan njerëz dhe jo vetëm ndryshime ligjore.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Beqaj!

Fjalën e kanë zoti Luka, pastaj zonja Gjermani.

Lorenc Luka – Gjatë aktivitetit tuaj kuptova se ka pasur edhe raste që janë shfaqur elemente selektive gjatë auditit, monitorimit që keni bërë. Dua të di: cilat janë hapësirat dhe mundësitë që u krijohen këtyre kompanive të ankimojnë padrejtësisë që u janë shkaktuar gjatë kontrollit nga këto grupe?

Së dyti, kur ju keni bërë thirrje, por nuk keni pasur përgjigje, cili është shkaku që nuk u kthejnë përgjigje thirrjeve tuaja?

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Luka!

Fjalën e ka zonja Gjermani, pastaj zoti Sinaj.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Duket që Inspektorati ka një fushë të gjerë përgjegjësie, me shumë kompetenca, me shumë fusha për të mbuluar.

Pyetja e parë: a i kemi kapacitetet e nevojshme për ta realizuar misionin që kemi në të gjitha këto fusha që ju përmendët? E kam fjalën për stafin, për ekspertizën, për burimet njerëzore, për trajnimet, për mbulimin e territorit.

E dyta, çfarë marrëdhënie keni me Shoqatën e Konsumatorëve? A janë ata të pranishëm; si i adresoni çështjet e tyre; a keni marrëdhënie bashkëpunimi, përfshirjeje; a u përgjigjeni kërkesave që ata kanë; a merrni nga ata indicie apo sinjale lidhur me problematikat e ndryshme apo thjesht i identifikoni vetë?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Gjermani!

Vullnet Sinaj – Në përgjithësi, të gjitha pyetjet që drejtuan kolegët do ta plotësojnë të gjithë kuadrin e dilemave që kisha unë. Unë kam vetëm një pyetje: ku lidhet konkretisht puna e Inspektoratit me ligjin për mbrojtjen e konsumatorit; ku e keni lidhur ju, pra ku janë indikatorët në aktivitetin tuaj të përditshëm që na japin neve rezultatin për të mbrojtur konsumatorin shqiptar?

Fushat që mbulon inspektorati tuaj më duken shumë të gjëra dhe nuk e di se sa do t'i realizoni. Një pikë shumë e rëndësishme është ajo që të na thoni se çfarë kërkon, një gjë që mund të bëhet më mirë në këtë kuadër për ta realizuar sa më mirë mbrojtjen e konsumatorit. Pra, çfarë ndihme mund t'u japim edhe ne si komision për t'iu ardhur në ndihmë juve, pra të jetë në të mirë të konsumatorit shqiptar?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Sinaj!

A ka ndonjë pyetje tjetër për ligjin e paraqitur? Pra, ne kemi një ligj për mbrojtjen e konsumatorëve. Zonja Gjermani përmendi Shoqatën e Konsumatorë, në fakt ka disa të tilla. Nuk dimë nëse ka një databazë se cilat janë dhe ku operojnë, por ne kemi pasur disa të tilla në komision në dëgjesa. Pra, cili është pozicioni juaj në lidhje me këto amendime të parashikuara në Kuvend?

Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, fjalën e ka zonja Xhixha.

Ejana Xhixha – Faleminderit për pyetjet, sepse janë ezaurim i gjithçkaje që kishim nevojë të ndanim me ju!

Raporti me Inspektoratin Qendror dhe me inspektoratet e tjera është një raport i rregulluar në ligjin e inspektimit, ku Inspektorati Qendror ka vetëm rolin e koordinimit dhe hartimit të manualit të procedurave që duhet të jenë njësuara nga të gjitha inspektoratet në Republikën e Shqipërisë. Sipas reformës së vitit 2011, ligji i inspektimit ka përcaktuar parimin: një ministri, një inspektorat, që do të thotë se fusha e përgjegjësisë e ministritë i korrespondon monitorimit në terren të zbatimit të legjislacionit të hartuar pikërisht nga ministria përgjegjëse. Gjithashtu, dua të them se raporti me Inspektoratin Qendror tashmë është konsoliduar edhe te pjesa e platformës *e-inspektimi*, ku Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut, në vlerësimin tonë, duke përjashtuar modestinë këtu, është një histori suksesi. Jemi 100% *online*, pavarësisht vështirësive teknike që kanë ekzistuar dhe ne sot operojmë me *check-lista* standarde, të cilat janë miratuar nga ne, janë miratuar nga Inspektorati Qendror, janë në faqen *online* të Inspektoratit Qendror, pra çdo operator ekonomik trajtohet në të njëjtën mënyrë dhe kanë të njëjtin proces pyetësori dhe verifikimi faktik. Pra, nëse ne shkojmë te një stacion plazhi, stacioni i plazhit, pavarësisht se është në Velipojë apo në Himarë, ka të njëjtën listë të kontrolluar nga inspektori dhe të gjitha gjetjet janë të hedhura në këtë platformë, e cila administrohet nga Inspektorati Qendror, pra jo nga vetë institucioni dhe atje hidhet procesverbali, *check-lista* e plotësuar dhe të gjitha fotot apo dokumentet shtesë që mbështesin gjetjet e konstatuara.

Reforma e inspektimit “një ministri, një inspektorat” është një reformë që i shkon për shtat edhe strukturës së BE-së dhe çdo shteti anëtar, sepse sot BE-ja në total ka rreth 628 inspektorate, ku vetëm Italia ka 64, sepse shkojnë drejt profilizimit të ngushtë në fusha të caktuara, sipas përgjegjësisë të ministrive, dhe kjo është linja kryesore mbi të cilën organizohet struktura në BE dhe në shtetet e tyre anëtare.

Për sa u përket masave administrative në stacionet e plazheve, në i inspektuam rreth 700, nuk konstatuam 7 subjekte në shkelje. Po ju them se për shkak të detyrës së lënë në inspektim nuk u treguam represivë ndaj operatorëve, por ju lamë një kohë të mjaftueshme të parashikuar edhe në ligjin e inspektimit, pra ju lamë detyrë ta merrnin këtë kontratë dhe operatori të ishte në konformitet me kërkesën ligjore, gjithashtu bashkia të arkëtonte të ardhura nga ajo kontratë e munguar.

Për sa i përket pyetjes për indikatorët matës se sa është përmirësuar mbrojtja e konsumatorit, desha të bëj thjesht një saktësim të vogël. Zoti Beqaj tha se ka 2 vjet e gjysmë, unë u përpoqa të shpjegoja që ne juridikisht jemi krijuar në janar 2016, por ekzistencën në

tregje e kemi që në korrik të vitit 2017. Pra, kemi vetëm një vit në treg. Në mbrojtjen e konsumatorit mund të themi se tregjet i kemi shkundur në kuptimin e rehatisë dhe të fshehjes pas fakteve: “nuk e dinin; nuk na i ka kërkuar njeri; ligji është i vjetër; kurrë nuk e kemi ditur; nuk na i keni kërkuar etj.” Pra, kemi ndërgjegjësuar operatorin të marrë masa, të vijë në konformitet që kur ne të shkojmë për inspektim, të mos kenë më instrumente për t’u fshehur pas gjërave që i kanë detyrim për t’i zbatuar. Ne ta vazhdojmë procesin siç parashikon ligji i inspektimit dhe ligji specifik. Në rastin konkret mund të japim disa shembuj për të ilustruar mbrojtjen e konsumatorit. Në dhjetor të vitit 2017 kemi inspektuar, sipas një databaze, të ofruar nga bashkëpunimi me doganën të importuesve kryesorë të lodrave në Republikën e Shqipërisë, duke bërë një kalkulim mbi xhiron, pra kemi bërë një rend zbritës, sepse këto janë kapacitetet tona, dy grupe inspektimi kemi në këtë fushë grup produktesh, janë 16 operatorët më të mëdhenj importues të lodrave, dhe kemi konstatuar edhe në Tiranë produkte që kanë qenë në faqen e RAPEX-it, pra që është sistemi i shkëmbimit të informacionit të shpejtë të Bashkimit European, si produkte të rrezikshme, që kanë ndaluar qarkullimin dhe hyrjen në tregjet e tyre. Ne i kemi konstatuar dhe është marrë masa për bllokimin e menjëhershëm të tyre, të cilat kanë qenë produkte për shkatërrim. Në raste të tjera kemi marrë masat për prodhuesit e detergjenteve apo importuesit e detergjenteve. Edhe në këtë rast kemi marrë masën e bllokimit të menjëhershëm apo detyra për plotësimin e analizave teknike që kërkon rregulli teknik.

Eduard Shalsi – Zonja Xhina, ju thatë se keni një *website*, apo jo?

Ejana Xhixha – *ishmt.gov.al*.

Për sa i përket vizitueshmërisë së faqes, me duhet të them se kemi vetëm një muaj që e kemi përfunduar faqen. Kështu që nuk besoj së të dhënat e këtij muaji janë një tregues që mund të na ndihmojë. Megjithatë, të gjitha produktet kanë shpjegimin e tyre ligjor dhe detyrimet. Gjithashtu, për lodrat vazhdoj të insisto, sepse është një produkt që edhe nga Bashkimi European është sugjeruar si grup- produkt që duhet të ndiqet, së pari, nga inspektorati ynë, sepse ata e kanë ndjekur, sikurse ju e nënvizuat, rëndësinë e ngritjes së këtij institucionit dhe ne jemi sot kontribuues në tre kapituj: te kapitulli I “Lëvizja e mallrave; kapitulli VII “Pronësisë intelektuale”, kapitulli XXVIII “Mbrojtja e konsumatorit”. Kështu që kam përshtypjen se jemi ndër institucionet e pakta ligjzbatuese, pra nivel i dytë, të institucioneve të varësisë që raportojmë për tre kapituj. Kjo e rrit edhe më shumë përgjegjësinë, por për shkak të ndjekjes në mënyrë strikte dhe me shumë dëshirë, për të qenë vullnetplotë dhe për të përmbushur sadopak atë pritshmërinë e mezipritur edhe të Bashkimit European për ngritjen e një strukture paralele, sidomos për lëvizjen e lirë të mallrave, ku është

fokusi kryesor i tyre. Ne kemi gjeneruar statistika reale dhe në raportimin e fundit kemi marrë vlerësime të mira që na e bëjnë me të lehtë përballimin e këtyre sfidave të mëdha. Sigurisht që nuk flasim për nivele vetëkënaqësie apo euforie, sepse sfidat dhe boshllëqet janë aq të mëdha sa në fund të ditës...

Për sa i përket pyetjes tjetër në lidhje me selektivitetin, ne thamë që jemi një institucion i ri dhe na mungon databaza e operatorëve ekonomikë, kështu që ne jemi në fazën e informimit të operatorëve dhe aty ku shkojmë për të informuar marrim edhe të dhënat e tyre. Pa plotësuar databazën ne nuk mund të bëjmë metodologjinë e riskut të inspektimit, e cila, për hir të së vërtetës, është proces që koordinohet nga inspektorati qendror. Ata kanë filluar një projekt pilot me dy institucione, që janë më kryesorët, AKU-në, për pjesën ushqimore dhe ISHMT-në për pjesën konsumatore joushqimore, por që pa pasur databazën e operatorëve nga vizitat inspektuese, masat administrative dhe sjelljet administrative, sigurisht nuk mund të gjenerojmë të dhëna mbi të. Kështu që ne jemi në fazën e ngritjes së këtij sistemi. Mund të ketë ndodhur që të ketë pasur selektivitet në përzgjedhjen e operatorëve që janë inspektuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht, unë thashë të kundërtën, ne detyruam operatorët përmes informimit, nuk u treguam represivë, por u lamë kohë. Të kini parasysh që stacionet e plazhit, për të cilat unë referova, janë biznese sezonale dhe ato masa administrative që ne kemi vënë dhe janë lënë në fuqi nga gjykata, sot janë të paarkëtuara, sepse stacioni i plazhit në momentin që mbyllet, bën pezullim në QKB dhe gjobat mbeten pa u arkëtuar dhe qëllimi i inspektimit nuk arrihet.

Kemi 300 kontrata të lidhura, 200 milionë lekë janë arkëtuar në buxhetin e pushtetit vendor dhe masat administrative kanë qenë vetëm 50 në 700 subjekte të inspektuara. Meqenëse ishim një institucion i ri, ne prezantuam veten dhe njohëm operatorët.

Lidhur me pyetjen për kontratat, unë ju thashë që ato nuk janë një dokument administrativ ligjor, që ne e kërkojmë për kryeneçësi dhe vëmë 2 milionë lekë gjobë. Këto janë sanksione që parashikohen drejtpërsëdrejti nga ligji i turizmit dhe Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut në raport me ligjin për turizmin ka vetëm këto dy sanksione: për stacionin e plazhit, nëse ka apo s'ka kontrata, por për sa i përket largësisë së shezllonëve, ruajtjes së vijës së parë, dhe kushteve higjienike mjedisore nuk ka asnjë forcë shtrënguese, por është detyrim i pushtetit vendor dhe këtu lidhet përgjegjësia e pushtetit vendor me operatorin. Kontrata nënkupton që subjekti i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe pas verifikimit të këtyre kriterëve, siç janë siguria, baywatch-it, korridori i hyrjeve-daljeve të mjeteve motorike nga uji, flamurëve të detit, të cilat janë elemente të sigurisë, por që ligji nuk ka parashikuar asnjë

masë administrative, bashkia ka kompetencën të garantojë se këto kritere janë përmbushur dhe operatori mund ta ushtrojë këtë lloj veprimtarie.

Për sa u përket instrumenteve që operatori ka në dorë sipas legjislacionit për t'u mbrojtur nga një proces i padrejtë dhe selektiv, mund t'ju them se ligji i inspektimit parasheh, parashikon dhe garanton një proces administrativ ankimimi, ashtu siç parashikon edhe procesin e ankimit gjyqësor në Gjykatën Administrative. Pra, kemi dy hallka. Pas vendimit përfundimtar të inspektorit, i cili merret në kohë reale dhe është i aksesueshëm në një platformë, që është 100%, transparente, subjekti brenda 30 ditëve ka të drejtë të ankimohet në komisionin e ankimit brenda Inspektoratit.

Meqenëse ne kemi fushë të gjerë veprimtarie, Komisioni i Ankimit të Inspektoratit në vendimin e qeverisë, me të cilin jemi krijuar, parashikon që në komisionin tonë ne kemi përfaqësues nga Ministria e Turizmit, nga Ministria e Kulturës dhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, që është institucioni përgjegjës, që do të thotë se kompozimi i Komisionit është gjithëpërfshirës, tërësisht profesional, për këtë arsye janë ftuar ekspertët nga këto ministri, dhe vendimmarrja është kolegjiale dhe rregullohet sipas ligjit për organet kolegjiale dhe pas kësaj procedure është e drejta e ankimit gjyqësor.

Për sa u përket kushteve institucionale, logjistike, burimeve njerëzore dhe kapaciteteve, kemi vërtet nevojë për çdo element të sipërpërmendur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e parashitja cektazi në fjalën hyrëse, kur ju thashë se janë funksione që vijnë për herë të parë.

Dua të qartësoj edhe deputetin Baraj që ka qenë një drejtori e Mbrojtjes së Konsumatorit, por nuk ka pasur funksione inspektuese, që do të thotë se ata merreshin me hartim politikash, me informim e të tjerë, por realisht nuk e di se cili ka qenë objekti i veprimtarisë së tyre. Unë mendoj se për sa kohë ka qenë një drejtori brenda Ministrisë së Ekonomisë, sigurisht që nuk ka pasur funksion inspektimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në raport me ligjin, ne lidhemi vetëm te pjesa e sanksioneve për sa u përket detyrimeve që ligji aktual, nenet 7,8 dhe 9 referojnë për informimin vizual, specifik dhe të dukshëm që duhet të ketë produkti për elementet e etiketimit. Pra, çdo produkt duhet të ketë etiketën në shqip, peshën, çmimin në lek dhe periudhën e garancisë përtej produkteve ushqimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thashë me një fjali, që kemi shumë nevojë. Me mbështetjen e Ministrisë së Financave, e cila ka aplikuar te fondet IPA për një projekt për ngritjen e kapaciteteve dhe ngritjen e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, ne jemi përfitues të këtij projekti dhe në shtator ne përfitojmë një projekt, që besoj se do të jetë shterues për nevojat e ngritjes dhe minikapaciteteve për ta strukturuar dhe për të ecur mbi bazën e kësaj strukture.

Burimet njerëzore janë problem i thellë, sidomos në fushat inxhinierike. Ne i kemi plotësuar 100% rregullat teknike, që burojnë nga direktiva, ndërkohë që operatorët, të cilët operojnë në tregun shqiptar, kanë mangësi të mëdha organizimi, njohje të këtyre standardeve dhe pamundësi reale për t'i përmbushur. Prandaj ne po e ngremë paralelisht procesin, po rritemi vetë, duke rritur edhe operatorët ekonomikë, në mënyrë që ata të ndërgjegjësohen për atë që ne do të bëjmë dhe të arrijmë objektivin pa kosto administrative të shtuara.

Filozofia jonë nuk është të sanksionojmë operatorët ekonomikë, pasi jemi koshient për vështirësitë dhe sfidat që ata kanë në tregjet ku ata operojnë, por nga ana tjetër kemi edhe detyrimin për të zbatuar ligjin specifik, i cili është taksativ. Në disa raste edhe ne vihem në vështirësi, sepse ka raste që nuk përputhen. Për shembull, neni i propozuar nga ne te Ministria e Ekonomisë të ligji për mbrojtjen e konsumatorit, masat administrative gjobë për subjektet, duke variuar mbi xhirot,

nuk ishte aplikuar asnjëherë si masë dhe ishte tërësisht abuzive dhe e pamundur në interpretim, sepse ligji caktonte 1% të xhiros vjetore të vitit paraardhës, por ndërkohë ky grup produkti, për të cilin operatori nuk e kishte në konformitet, mund të ishte 1% në totalin e të ardhurave që krijonte grupi i tij ose aktiviteti i tij dhe ndëshkohej në mënyrë abuzive dhe të palogjikshme i gjithë totali i xhiros së një kompanie me 100 produkte për një produkt që nuk ishte në konformitet. Kjo masë nuk ishte sanksionuar ndonjëherë dhe në interpretim do të ishte tërësisht abuzive dhe e padrejtë ndaj interesit të operatorit ekonomik, sepse balanca midis interesit të ligjshëm dhe interesit publik të sanksionuar në këto standarde dhe rregulla teknike është i barasvlershëm në këndvështrimin dhe interpretimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Për sa u përket mbivendosjeve, zhvendosjeve dhe transferimeve të kompetencave, ky është një konstatim shumë i drejtë dhe shpeshherë kthehet në një shqetësim periodik. Shpresoj që reforma në inspektim t'i japë zë të gjithë problematikës që ka shfaqur inspektimi.

Kohët e fundit ne jemi prekur nga një ndryshim strukture, sepse Drejtoria e Inspektimit të Standardeve në Turizëm u shkëput nga ne, kur ne kishim shpenzuar për një vit energjitë më të mëdha dhe bëmë një proces shumë të mirë, u transferua pranë Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave dhe Pyjeve, në varësi të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit.

Eduard Shalsi – Komponenti i dytë i standardeve të turizmit, ka kaluar nga ju te...

Ejana Xhixha – Prej një muaji është transferuar juridikisht si kompetencë, pavarësisht se inspektorët fizikisht vazhdojnë të jenë te ne, është procedurë administrative e komisionit të ristrukturimit të DAP-it, por nuk është gjë e mirë, sepse inspektorët në këtë periudhë duhet të ishin në terren.

Për sa i përket shoqatës së konsumatorëve, ne jemi në komunikim të vazhdueshëm me ta dhe u kemi thënë se çfarë nuk ecën mirë dhe cilave shqetësime mund t'u japim zë me këto kompetenca që kemi.

Lidhur me produktet lodër, vazhdoj të insisto, sepse përdoruesit e këtij grupi janë grup shumë vulnerabël dhe ne i kemi kushtuar shumë rëndësi. Me shoqatën e konsumatorëve kemi përzgjedhur pikërisht pjesën më problematike për diskutim. Më 1 Qershor, ditën e fëmijëve, organizuam dy aktivitete, njëri ishte pranë parkut të liqenit, ku vendosëm disa tryeza të vogla me skica mjedisore dhe sigurinë për lodrat, fëmijët ngjyrosnin dhe prindërit merrnin informacion se si duhet të përzgjidhnin lodrat në momentin e blerjes. Paralelisht bëmë edhe një *workshop* me importuesit, doganat dhe shoqatat e konsumatorëve për shpjegimin e standardit të ri që tregu dhe inspektorati kërkon për këto produkte, në mënyrë që të jenë të aksesueshme në treg. Mendoj se kjo është një nga fushat që unë mendoj se kemi ecur shumë mirë. Aktualisht jemi duke marrë informacion dhe jemi duke identifikuar problematikën në tregun e detergjenteve, më pas do të vijojmë me sektorë të tjerë, sepse produktet janë me shumë specifika teknike. Në Shqipëri, por edhe në rajon, nuk kemi laboratorë të akredituar për kontrollin e detergjenteve dhe për qëllime marrjeje mostër neve na u desh të çonim një mostër në Milano. ISHMT-ja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kishte as rajoni.

Eduard Shalsi – Ka pyetje të tjera?

Zonja Xhixha, ju falënderoj!

Në fakt, ju thatë që nuk keni ende mjedisë, pasi duam të vijojmë kontakte midis nesh për t'u informuar më me detaje dhe për të parë se çfarë mund të bëjmë ne si komision për plotësimin e nevojave. Personalisht besoj se është një inspektorat që duhet fuqizuar.

Duke pasur parasysh edhe rrezikshmërinë e produkteve, ju përmendet një fakt, i cili në vëmendjen tonë ka ardhur shumë kohë më parë nga disa të huaj, të cilët kishin parë produkte fëmijësh, që ishin deklaruar krejtësisht të papërshtatshme dhe jashtëzakonisht të rrezikshme.

Duhet të këmbeni emailët me stafin dhe punonjësit e komisionit, në mënyrë që të mbani një urë komunikimi të vazhdueshme.

Ne besojmë fort se duhet mbështetur fort institucioni që ju drejtoni, në mënyrë që të funksionojë sa më mirë.

Edhe dje gjatë vizitës që bëmë tek Autoriteti i Aviacionit Civil përmendem se është e tmerrshme historia e emërimeve që dëgjojmë në institucionet e tjera. Është i tmerrshëm fakti i mbajtjes së protokollit në këto institucione, lere pastaj idenë e qokave politike dhe foleve të të paaftëve dhe joprofesionalë, sepse është shumë e rëndësishme që në institucione të tilla të dominojë kriteri profesional. Unë personalisht i dija një pjesë të problematikave, por vizitat nëpër institucionet e ndryshme, që kanë qenë intensive gjatë këtyre muajve, më kanë alarmuar aq shumë, sa që duhet t'u biem kambanave të alarmit. Unë së bashku me kolegët kemi vendosur që të mbikëqyrim edhe procesin e rekrutimeve, sepse kemi dëgjuar histori të çuditshme dhe krejtësisht të pafalshme për standardet që duam të arrijmë.

Më besoni, kolegë, që kur pamë fotografitë e protokollit dhe CV-të, situata ishte e frikshme dhe alarmante. Unë mendoj se në këto institucione elementi i djathtë, i majtë dhe partiak duhet të jetë i fundit. Nuk ka asgjë të jesh militant partiak dhe profesionalist, por të jesh militant pa profesion dhe të strehohesh në institucione të tilla, ku varet siguria ajrore, siguria ushqimore dhe përditshmëria...

Unë besoj se emërimet bëhen me etapa dhe rekrutimi është me kriter profesional.

Ejana Xhixha – Po.

Eduard Shalsi -Faleminderit, edhe një herë, do të mbetemi në kontakt!

Ejana Xhixha – Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA